



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 42, QARKU TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 42, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.413 datë 16.05.2019, ka caktuar VNV e KZAZ nr.42 në në shkollën e mesme "Aleksandër Moisiu", palestra me sipërfaqe 480 m², Bashkia Kavajë.

Prefekti i Qarkut Tiranë, bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", me shkresën nr.12429 prot., datë 27.06.2019, informon se ambienti i palestrës së Shkollës së Mesme "Aleksandër Moisiu" ndodhet në kushte krejtësisht të papërshtatshme për të zhvilluar procesin e numërimit të votave, pasi vijon rikonstruktimi i Shkollës dhe për këtë shkak palestra është e bllokuar me materiale dhe inerte.



Nr. 881 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 10.00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 42, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Në vlerësim të situatës, Prefekti i Qarkut Tiranë, propozon që VNV e ZAZ nr. 42 të jetë në Shkollën 9-vjeçare "3 Dëshmorët", palestra me sipërfaqe 230 m², atje ku është dhe Selia e KZAZ nr. 42.

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor ka sipërfaqe mbi 230 m², duke plotësuar kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 42, në Shkollën 9-vjeçare "Tre Dëshmorët", palestra me sipërfaqe 230 m².
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 881 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 10.00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 42, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019